



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 4081 prot.

Himarë, më 02.06 . 2025

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi për “Dhënien e miratimit në parim për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullor të një sipërfaqe prej 1 ha, nr.pasurie 2/78 , Zk:3844 në favor të shoqërisë “SOLEIL&SEA” sh.p.k., pwr aktivitetin: “SHFRYTËZIM PËR PARKIM TË AMBJENTIT PËR MAKINERITË E INERTEVE, PËR NEVOJA TË KOMPANISË”

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË,

Himarë

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin 57/2020, date 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”; V.K.M-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM-në nr. 559 ,datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim /përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projektvendimin pwr “Dhënien e miratimit në parim për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullor të një sipërfaqe prej 1 ha, nr.pasurie 2/78 , Zk:3844 në favor të shoqërisë “SOLEIL&SEA” sh.p.k., pwr aktivitetin: “SHFRYTËZIM PËR PARKIM TË AMBJENTIT PËR MAKINERITË E INERTEVE, PËR NEVOJA TË KOMPANISË”

- Relacion: Mbi projekt vendimin për Dhënie e miratimit në parim për dhënie në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1 ha, nr.pasurie 2/78 , Zk:3844 në favor të shoqërisë “SOLEIL&SEA” sh.p.k., pwr aktivitetin: “SHFRYTËZIM PËR PARKIM TË AMBJENTIT PËR MAKINERITË E INERTEVE, PËR NEVOJA TË KOMPANISË”

KRYETARI

Vangjel Tavo



NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Pervin Gjiguria



REPUBLIKAE SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 4081/prot.

Himarë, më 02.06.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 24, Datë 02.06/2025

PËR

“DHËNIEN E MIRATIMIT NË PARIM PËR DHËNIEN NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 1 HA, NR.PASURIE 2/78 , ZK:3844 NË FAVOR TË SHOQËRISË “SOLEIL&SEA”SH.P.K.

AKTIVITETI:

“SHFRYTËZIM PËR PARKIM TË AMBJENTIT PËR MAKINERITË E INERTEVE, PËR NEVOJË TË KOMPANISË”

Bazuar ne ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive te pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin 57/2020, date 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”; V.K.M-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI:

1.Dhënien e miratimit në parim për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1 HA, NR.PASURIE 2/78 , ZK:3844 në favor të shoqërisë “SOLEIL&SEA”sh.p.k., për aktivitetin : “Shfrytëzim për parkim të ambjentit për makineritë e inerteve, për nevoja të kompanisë”.

3. Për zbatimin dhe ndjekjen e të gjithë hapave proceduralë ligjorë të këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI

Vagjel Tavo



**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Pervin Gjiguria



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 4081 / prot.
12

Himarë, më 02.06 . 2025

RELACION:

**MBI PROJEKT VENDIMIN PËR “DHËNIEN E MIRATIMIT NË PARIM PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE
PREJ 1 HA, NR.PASURIE 2/78 , ZK:3844 NË FAVOR TË SHOQËRISË
“SOLEIL&SEA”SH.P.K.**

AKTIVITETI:

**“SHFRYTËZIM PËR PARKIM TË AMBJENTIT PËR MAKINERITË E INERTEVE,
PËR NEVOJA TË KOMPANISË”**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi që po ju paraqesim vjen pasi kemi marrë dhe shqyrtuar një kërkesë nga SHOQËRIA “SOLEIL&SEA”sh.p.k, për shprehje interesi për të zhvilluar aktivitetin e tij në fushën e “SHFRYTËZIM PËR PARKIM TË AMBJENTIT PËR MAKINERITË E INERTEVE, PËR NEVOJA TË KOMPANISË”.

Vetë shoqëria ka kryer kërkimet dhe studimet e saj në territorin e bashkisë Himarë ku dhe ka zbuluar një zonë sipas hartës bashkëlidhur këtij relacioni. Pas verifikimeve në terren është vërejtur se kjo përbën një zonë e cila nuk ndikon në mjedis dhe ndodhet larg rrugës kryesore pra rrjedhimisht nuk ka impakt mjedisor pranë rrugës kryesore dhe fshatrave përreth.

I. BAZA LIGJORE:

Ky projekt-vendim mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi:

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 9, 27 dhe 54;
- VKM nr. 433, datë 08.06.2016 (i ndryshuar);
- Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 5;
- VKM nr. 592, datë 09.10.2018;

- VKM nr. 888, datë 27.12.2022, për rregullat dhe procedurat për dhënien në përdorim dhe ndryshimin e kategorisë së përdorimit.

II. ARSYETIMI I KËTIJ VENDIMI:

Shoqëria “Soleil & Sea” sh.p.k. ka paraqitur një kërkesë për përdorimin e një sipërfaqeje 1-ha për **parkimin dhe pozicionimin e makinerive të rënda**, të nevojshme për aktivitetin e saj në fushën e përpunimit të inerteve.

Bashkia Himarë ka kryer verifikimet ligjore dhe teknike dhe ka konstatuar se:

- Sipërfaqja e kërkuar nuk është objekt përdorimesh të tjera publike ose private;
- Tokës i përshtatet qëllimi i përdorimit të përkohshëm si zonë teknike për makineri;
- Ndikimi mjedisor është i kontrollueshëm dhe i kufizuar;
- Aktiviteti ekonomik pritet të ndikojë pozitivisht në punësim dhe të ardhura për bashkinë.
- Në të gjitha rastet duhet të kihet parasysh se Bashkia Himarë do të ndjekë një rrugë të kujdesshme ligjore në lidhje me aktin final të dhënies së kontratës së qirasë.

III. KUSHT I VEÇANTË I ZBATIMIT:

Ky miratim në parim jepet me kushtin që ai të ndërpritet menjëherë në rast se ndodhin **përditësime ose ndryshime në statusin e pronësisë** së pasurisë nr. 2/78, ZK 3844. Në një situatë të tillë, çdo procedurë e mëtejshme ndalohe dhe rivlerësohet në përputhje me dokumentacionin e ri ligjor apo kadastral.

IV. PËRFITIMET E PRITSHME:

- Përdorim racional dhe i përkohshëm i një sipërfaqeje pa ndikim të dëmshëm afatgjatë;
- Mbështetje për një aktivitet të ligjshëm ekonomik;
- Rritje e të ardhurave për buxhetin vendor;
- Krijim i kushteve për zhvillim lokal të kontrolluar.

V. KONKLUZIONI:

Në përputhje me dokumentacionin ligjor dhe teknik, dhe me **kushtin e pezullimit automatik të miratimit në rast ndryshimesh në pronësi, rekomandohet miratimi në parim i këtij projekt-vendimi** dhe procedimi i mëtejshëm sipas rregullave të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse.

Këshilli Bashkiak i Himarës është i ftuar të shqyrtojë dhe të aprovojë këtë projekt vendim për të mundësuar implementimin e projekteve të mëdha infrastrukturore që do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës.

Bashkëlidhur këtij relacioni:

1. Kopje e kërkesës së shoqërisë “SOLEIL&SEA”sh.p.k.

KRYETAR
Vangjel Tavo



NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI
Pervin Gjikutria